

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“HOOKS ALBANIA”**

Sot me date 12/10/20222 u paraqiten palet e meposhtme:

*Shoqeria HAKEN S.R.L. , me nr. IVA: 12528540011, dhe adrese ne TORINO, VIA PIETRO MICCA 20 CAP 10122, Itali, me aksionere te vetme Shoqerine “HOKOJ SOCIETA' SEMPLICE”, e cila ka aksioner (ortak te vetem perfundimtar) shtetasin: Federico Ganci, shtetas Italian, lindur me 23.10.1984 ne Torino dhe banues ne Itali, me pasaporte nr: YB9035236, i autorizuar me vendim asambleje per te firmosur dhe perfaqesuar shoqerine Haken S.R.L.*

*Konti Tafili, shtetas Shqiptar , lindur ne Durres me 07.06.1995 dhe banues ne Tirane, me leternjoftim nr : 037631148 dhe me numer personal : J50607088D.*

Te cilet kane vendosur te nenshkruajne Aktin e Themelimit te meposhtem te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, aktiviteti te ciles rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi dhe nga statuti i saj, i cili eshte pjese perberse e ketij akti .

**Neni 1 – Emertimi**

Emertimi i shoqerise eshte **“HOOKS ALBANIA”**

**Neni 2 – Selia**

Selia e shoqerise ndodhet ne: Rruga “Sulejman Delvina”, Qendra Zayed, kati 7A, Tirane.

**Neni 3 – Kohezgjatja**

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete me afat te pacaktuar.

**Neni 4 – Objekti I shoqerise**

1. Objekti i shoqerise eshte : Aktivitete te projektimit, analizes dhe zhvillimit te sistemeve kompjuterike te te gjitha llojeve, aktivitete te marketingut online nepermjet telefonit, emailit dhe cdo forme elektronike, menaxhimin e qendres se thirrjeve per marketingun online per shoqeri te huaja dhe Shqiptare, sherbime te telemarketingut, perpunimit te te dhenave, konsulence per shoqerite e huaja dhe shqiptare per realizimin e marketingut online ne motoret e kerkimit ne internet, import – export produktesh dhe sherbimesh, aktivitetet editoriale (duke përfshirë botimin e Gazetave), trajnime dhe konsulence per kompanite e huaja dhe Shqiptare, shitja e produkteve dhe sherbimeve per vete dhe per te trete, shitja e produkteve dhe sherbimeve ne lidhje me rrjetet kompjuterike dhe paisjet elektronike, mirmbajtja e rrjeteve kompjuterike, menaxhimi i fushatave te marketingut per kompanit e huaja nepermjet telefonit dhe emailit, tregtia me shumice dhe pakice e te gjitha produkteve elektronike per vete dhe per te trete, ofrimi i sherbimit te asistences teknike nepermjet telefonit per kompanite e huaja dhe shqiptare ne lidhje me rrjetet kompjuterike dhe software, perpunimi te dhenave per kompanite e huaja, prodhimi blerja dhe shitja e software, krijimi dhe menaxhimi i fushatave te marketingut te te gjitha formave, menaxhimi i numrave te gjelber per kompanite e huaja, menaxhimi dhe shitja e blerja e pasurive te paluajtshme letrave me vlere dhe te gjitha format e aksioneve te te gjitha llojeve, dhenia me qera e objekteve dhe paisjeve, shitje me shumice dhe pakice e te gjitha llojeve te produkteve qe sjellin te ardhura per kompanine, krijimi dhe menaxhimi i te gjitha llojeve te produkteve, sherbimeve dhe paisjeve elektronike ne fushen IT.
2. Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te saj.

## **Neni 5 – Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **25 000 (njëzetë e pesë mijë) Lekë.**

Ky kapital themeltar eshte ofruar ne kontribut ne para dhe eshte i perbere nga 2 kuota.

Pjesmarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e meposhtme ne para:

1. Shoqeria themeluese HAKEN S.R.L. : Zoterues i 1 (një) kuote me vlere te pergjithshme **20 000 (njëzetë mijë) Leke** qe perben 80% te kapitalit themeltar te shoqerise.
2. Ortaku themeltar Konti Tafili : Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme **5 000 (pesë mijë) Leke** qe perben 20% te kapitalit themeltar te shoqerise.

## Neni 6 - Transferimi kuotave

Kuotat I transferohen te treteve sipas parashikimeve te statutit.

## Neni 7 – Administrimi

I. Me kete akt emerohet 1 (nje) Administrator i Shoqerise personi si me poshte :

Z. Konti Tafili, shtetas Shqipetar , lindur ne Durres me 07.06.1995 dhe banues ne Tirane, me leternjoftim nr : 037631148 dhe me numer personal : J50607088D.

- II. Administratori do te ushtroje te gjitha kopetencat e administrimit te zakonshem, ne perputhje me parashikimet e nenit 95 te ligjit nr.9901, date 14 prill 2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe nenit te statutit.
- III. Adminitratorit I jepen te gjitha kopetencat e nevojshme per te kryer te gjitha formalitet dhe veprimet e parashikuara per themelimin e shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi. Per kete qellim, Administratori, mund tu drejtohet per ndihme te treteve ose konsulenteve te cilet mund te delegojne ne teresi ose pjeserisht kryerjen e aktivitetit te siperpermendur.
- IV. Administratori eshte gjithashtu i autorizuar te veproje ne emer te Shoqerise ne formim e siper deri ne regjistrimin e saj prane Qendres Kombetare te Biznesit. Ai gjithashtu eshte i autorizuar te firmose te gjitha aktet dhe te marre persiper detyrime ne emer te Shoqerise qe rrjedhin prej momentit te rregjistrimit te saj si edhe ka te drejte ti delegoje kopetencat e tij personave te tjere. Administratori eshte i autorizuar te hape llogarite bankare te shoqerise ne cdo banke ne Republikën e Shqiperise.

## Ortaket

**HAKEN S.R.L**

Federico Ganci

**Konti Tafili**

**STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“HOOKS ALBANIA”**

*Kreu 1*

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia**

**Neni 1**

**Forma e shoqerise**

Shoqeria ka formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e cila themelohet nga 2 ortakët(shoqerite) e meposhtem qe perballojne humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne Kapitalin Themeltar.

Veprimtaria e shoqerise do te regullohet nga ky statut, nga dispozitat perkatese te Ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008 “ Per tregjetaret dhe shoqerite tregtare” dhe Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” si dhe nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Shoqeria e fiton personalitetin juridik qe nga dita e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit ( QKB), ne regjistrin tregjetar.

**Neni 2**

**Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot me date 12.10.2022 , ne, themeluesit, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin “HOOKS ALBANIA”.

Themeluesit e shoqerise jane :

1. Shoqeria HAKEN S.R.L. , me nr. IVA: 12528540011, dhe adrese ne TORINO, VIA PIETRO MICCA 20 CAP 10122, Itali, me aksionere te vetme Shoqerine “HOKOJ SOCIETA’

SEMPLICE”, e cila ka aksioner (ortak te vetem perfundimtar) shtetasin: Federico Ganci, shtetas Italian, lindur me 23.10.1984 ne Torino dhe banues ne Itali, me pasaporte nr: YB9035236, i autorizuar me vendim assembleje per te firmosur dhe perfaqesuar shoqerine Haken S.R.L.

2. Konti Tafili, shtetas Shqiptar , lindur ne Durres me 07.06.1995 dhe banues ne Tirane, me leternjoftim nr : 037631148 dhe me numer personal : J50607088D.

### **Neni 3**

### **Objekti**

1. Objekti i shoqerise eshte : Aktivitete te projektimit, analizes dhe zhvillimit te sistemeve kompjuterike te te gjitha llojeve, aktivitete te marketingut online nepermjet telefonit, emailit dhe cdo forme elektronike, menaxhimin e qendres se thirrjeve per marketingun online per shoqeri te huaja dhe Shqiptare, sherbime te telemarketingut, perpunimit te te dhenave, konsulence per shoqerite e huaja dhe shqiptare per realizimin e marketingut online ne motoret e kerkimit ne internet, import – export produktesh dhe sherbimesh, aktivitetet editoriale (duke perjashtuar botimin e Gazetave), trajnime dhe konsulence per kompanite e huaja dhe Shqiptare, shitja e produkteve dhe sherbimeve per vete dhe per te trete, shitja e produkteve dhe sherbimeve ne lidhje me rrjetet kompjuterike dhe paisjet elektronike, mirmbajtja e rrjeteve kompjuterike, menaxhimi i fushatave te marketingut per kompanit e huaja nepermjet telefonit dhe emailit, tregtia me shumice dhe pakice e te gjitha produkteve elektronike per vete dhe per te trete, ofrimi i sherbimit te asistences teknike nepermjet telefonit per kompanite e huaja dhe shqiptare ne lidhje me rrjetet kompjuterike dhe software, perpunimi te dhenave per kompanite e huaja, prodhimi blerja dhe shitja e software, krijimi dhe menaxhimi i fushatave te marketingut te te gjitha formave, menaxhimi i numrave te gjelber per kompanite e huaja, menaxhimi dhe shitja e blerja e pasurive te paluajtshme letrave me vlere dhe te gjitha format e aksioneve te te gjitha llojeve, dhenia me qera e objekteve dhe paisjeve, shitje me shumice dhe pakice e te gjitha llojeve te produkteve qe sjellin te ardhura per kompanine, krijimi dhe menaxhimi i te gjitha llojeve te produkteve, sherbimeve dhe paisjeve elektronike ne fushen IT.
2. Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te saj.

## **Neni 4**

### **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete me afat te pacaktuar

## **Neni 5**

### **Selia**

Selia e shoqerise ndodhet ne: Rruga "Sulejman Delvina", Qendra Zayed, kati 7A, Tirane.

## **Kreu 2**

### **Kapitali**

## **Neni 6**

### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **25 000 (njëzete e pesë mijë) Lekë**.

Ky kapital themeltar eshte ofruar ne kontribut ne para dhe eshte i perbere nga 2 kuota.

Pjesmarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e meposhtme ne para:

3. Shoqeria themeluese HAKEN S.R.L. : Zoterues i 1 (një) kuote me vlere te pergjithshme **20 000 (njëzetë mijë) Leke** qe perben 80% te kapitalit themeltar te shoqerise.
4. Ortaku themeltar Konti Tafili : Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme **5 000 (pesë mijë) Leke** qe perben 20% te kapitalit themeltar te shoqerise.

## **Neni 7**

### **Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit**

Kapitali themeltar I shoqerise mund te zmadhohet pa kufi ne cdo moment,nje ose disa here, me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Kapitali I shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre,nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angzhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Ortaket, mund te zmadhojne kapitalin themeltar te shoqerise duke rritur kuotat ne shumen e percaktuar ne vendimin perkates. Zmadhimi i kapitalit me qellim pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, miratohet nga Asambleja e Ortakeve.

Zvogelimi I kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve,e cila mer vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi I prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

## **Neni 8**

### **Transferimi I kapitalit**

Kuotat e kapitalit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet :

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve dhe te treteve, per sa kohe nuk parashikohet ndryshe ne statut. Kjo mund te behet me nje kontrate dhurimi.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

### **Kreu 3**

## **Organet Vendimmarrese dhe Drejtuese**

### **Neni 9**

#### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise dhe qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme :

- A. Percaktimin e politikave tregetare te shoqerise
- B. Ndryshimet ne statut
- C. Emerimin apo shkarkimin e administratorve
- D. Emerimin apo shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- E. Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur me lart.
- F. Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret,perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise.
- G. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise
- H. Zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit
- I. Pjestimin e kuotave apo anulimin tyre
- J. Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorve
- K. Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- L. Miratimin e rregullave procedurale dhe mbledhjeve te asamblese
- M. Ceshtje te tjera te parashikuara

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarta me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Asambleja e pergjitheshme perbere nga ortaket vendos per ceshtjet e meposhtme:

- Ndryshimet ne statut
- Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit fillestar
- Shperndarjen e fitimit
- Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- Emerimin apo shkarkim te administratorve



## **Neni 10**

### **Mbledhja e Asamblese se Pergjitheshme**

Asambleja e Pergjitheshme thirret sa here qe mbledhja eshte e nevojeshme per te mbrojtur interesat e shoqerise Mbledhja e zakonshme e Asamblese se Pergjitheshme thirret te pakten nje here ne vit.

Asambleja e Pergjitheshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose ndepermjet postes elektronike , e cila duhet te permbaje daten, oren, vendin dhe rendin e dites , e tu dergohet te gjithe ortakeve , jo me vonë se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e Asamblese

Asambleja e Pergjitheshme thirret nga Administratoret apo ortaket, te cilet perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne Asamblene e Pergjitheshme te Shoqerise.

Asambleja e Pergjitheshme thirret nese , sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

Asambleja e Pergjitheshme thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5% te asetëve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Asambleja e Pergjitheshme thirret kur shoqeria brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj , propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vleren me te larte se 5 % te asetëve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

## **Neni 11**

### **Administrimi**

Asambleja e Pergjitheshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise per nje periudhe kohe 5 vjet me te drejte ripertesitje.

Me kete akt emerohet 1 (nje) Administrator I Shoqerise personi si me poshte :

Z. Konti Tafili, shtetas Shqipetar , lindur ne Durres me 07.06.1995 dhe banues ne Tirane, me leternjoftim nr : 037631148 dhe me numer personal : J50607088D.

Asambleja e Pergjitheshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumicen e zakonshme.

## Neni 12

### Kompetencat e administratorve

Administratorët kanë të drejtë të :

- Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asamblëja e përgjithshme.
- Perfaqësojnë shoqërinë tregtare
- Kujdesen për mbajtjen e saktë të dokumentave dhe librave kontabel të shoqërisë
- Pergatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumenta përpara Asamblëse së përgjithshme për miratim.
- Krijojnë një sistem paralajmërimi për rrethanat që kërcenojnë mbarvajtjen e veprimtarisë së shoqërisë.
- Të hapë llogaritë bankare për shoqërinë në çdo bankë në Republikën e Shqipërisë, pa qenë nevoja që të jenë prezente palet e tjera pjesëmarrëse në kapital.
- Raportojnë para asamblëse së ortakeve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare
- Kryejnë detyra të tjera të nevojshme për shoqërinë.
- Administratori ka të drejtë të kryejë transfertat deri në 10.000 Euro pa marrë një vendim asamblëje, dhe në rast se vlera e transfertave kalon shumën e lartpërmendur, atij i duhet një vendim asamblëje për të procesuar.
- Informojnë të gjithë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë dhe me kërkesë të tyre, duhet të vënë në dispozicion llogaritë vjetore, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë të shoqërisë, raportet e Organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabel të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër.
- Kryejnë çdo veprim për shoqërinë që nuk cenon interesin dhe mbarvajtjen e shoqërisë.
- Kryejnë regjistrimet dhe dergojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë.

## **Neni 13**

### **Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit**

Detyra e Administratorit përfundon ne rast se:

1. personi nuk eshte më Administrator sipas parashikimeve te Ligjit perfshire edhe parashikimet e pikes 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi ndodhet ne gjendje paaftesie paguese;
3. personi vuan ose mund te vuaje nga çrregullime mendore;
4. personi jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar shoqerine.
5. personi nuk ruan konfidencialitetin dhe informacionet e shoqerise, dhe nuk zbaton detyrat per mbarevajtjen e punes se shoqerise.

## ***Kreu 4***

### **Neni 14**

#### **Viti Financiar**

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor, perjashtimisht viti i pare financiar fillon nga data e rregjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

### **Neni 15**

#### **Fitimi**

Fitimet qe rezultojne nga bilanci vjetor u shperndahen ortakeve ne propocion me vleren nominale te kuotes se kapitalit themeltar te zoteruar.

## ***Kreu 5***

### **Neni 16**

#### **Prishja**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj.
- b) Me vendin te Asamblese se pergjitheshme
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit.
- d) Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise
- e) Me vendim gjykate

## **Neni 17**

### **Likuidimi**

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese,me perjashtim te rasteve kur eshte nisur procedura e falimentimit.

Per te administruar kete procedure Asambleja emeron nje ose me shume likuidatore,te cilet paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe te pasivit te shoqerise,mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohen e nevojshme per te perfunduar likuidimin.

Pas pagimit te kreditorve dhe mbledhjes se kredive, likuidatori do ti shprendaje te ardhurat perfundimtare te likuidimit ortakeve, ne propocion me vleren nominale te kuotes se zoteruar prej tyre ne kapitalin themeltar.

## **Neni 18**

### **Riorganizimi i shoqerise**

Shoqeria mund te ndahet,bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"

Ne rastet kur aktiviteti mbyllet, per shkak riorganizimi, afatet e mbylljes vendosen nga asambleja e pergjitheshme.

## **Neni 19**

### **Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis shoqerise dhe te treteve, do te jete kopetente Gjykata Shqiptare.

## **ORTAKET**

**HAKEN S.R.L**

**Federico Ganci**



**Konti Tafili**

